



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
UNIVERSITETI I TIRANËS
FAKULTETI I GJUHËVE TË HUAJA
DEPARTAMENTI I GJUHËS FRËNGE



PROGRAMI MËSIMOR I LËNDËS

Përkthim A-C

Ngarkesa: 6kredite;15 leksione, 45 seminare;60orë gjithsej

Viti akademik/Semestri kur zhvillohet: Viti I / Semestri I

Lloji i lëndës: Lëndë e detyruar

Programi i studimit: Master i Shkencave në “Përkthim teknik-letrar dhe Interpretim

Kodi i etikës: Kodi i etikës i UT-së (nenet 4, 6, 7, 9)

PËRMBLEDHJET DHE REZULTATET E TË NXËNIT:

Objektivat e përgjithshme lëndore:

- Përvetësimi i njohurive teorike dhe praktike në fushën e studimeve përkthimore dhe përkthimit.
- Aftësimi për të përcjellë një mesazh të shkruar nga gjuha C në gjuhën A duke respektuar synimet, publikun e synuar si edhe objektivat e autorit, duke iu brendashkruar kriterëve gjuhësorë dhe regjistrin përkatës.
- Përvetësimi i një deontologjie personale nisur nga parimet e përgjithshme të etikës profesionale të profesionit të përkthyesit.
- Analiza dhe formësimi i një gjykimi personal, të arsyeshëm dhe aktiv mbi burimet e ndryshme dhe literaturën e shfrytëzuar.
- Shkuarja drejt përsosjes së të kuptuarit të një teksti të shkruar në gjuhën C sikundër ndodh me folësin e lindur të asaj gjuhe.
- Analizë e të pathënës, aluzionit stereotipit, ndërtekstualitetit të një teksti.
- Identifikim i elementeve socio-kulturore të nënkuptuara në tekstin e shkruar.
- Përvetësim i teknikave dhe strategjive përkthimore të teksteve pragmatike nga gjuha frënge në gjuhën shqipe
- Përvetësim i mjeteve për të kuptuar / riformuluar / rishikuar tekstin

Objektivat specifike lëndore: Studenti duhet të njohë se si të:

- Të përftojë njohuri ndërkulturore të dobishme për procesin e të kuptuarit, analizimit dhe kontekstualizimit të veprimtarisë përkthimore orientuar nga një qasje ndërkulturore.
- Të mobilizojë dhe zhvillojë njohuri tematike duke zbuluar temat kryesore të shoqërisë dhe kuptojë stilin dhe terminologjinë e brendshme në secilën prej temave në fjalë.
- Marrë stërvitjen e nevojshme për të zotëruar aftësitë redaktuese të nevojshme për përkthyesin në mënyrë që të jetë efektiv në treg.
- Përforcojë kompetencën redaktuese në gjuhën amtare.

Rezultate të pritshme: Në fund të modulit studentët do të jenë të aftë:

- Të përkthejnë me saktësi dhe profesionalizëm, drejt gjuhës shqipe, mesazhin e tekstit të hartuar në gjuhën burimore-frënge.
- Të zhvillojnë kompetencën e të reflektuarit në mënyrë kritike në lidhje me përkthimin dhe sfidat e tij;
- Të arsyetojnë, argumentojnë dhe sistemojnë njohuritë në fushën e përkthimologjisë;
- Të ushtrojnë mendim analitik, kritik, logjik dhe kreativ duke prodhuar një argumentim të arsyetuar në lidhje me ligjërimin e përkthimit, aktin e të përkthyerit;